



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Tiranë, më 06. 06. 2023

NJOFTIM PËR BOTIM NË REVISTËN PEDAGOGJIKE

Të nderuar bashkëpunëtorë dhe të interesuar për të botuar në Revistën Pedagogjike,

Ju njoftojmë se janë hapur aplikimet për të dërguar artikuj për numrin e ri të Revistës Pedagogjike, 2023. Kjo revistë është botim i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP) me ISSN 0304-3509.

Fokusi i Revistës në këtë numër do të jenë tematikat e mëposhtme:

- Edukimi në lidhje me zhvillimin e qëndrueshëm
- Të nxënësve social dhe emocional i nxënësve
- Arsimit i kombinuar, sfidat dhe mundësitë
- Përdorimi i TIK-ut në procesin mësimor

Nëpërmjet artikujve që do të përqendrohen në këto tematika, synojmë të mundësojmë ndarjen e ideve, parashtrimin e analizave, përvojave, kërkimeve etj. Artikujt do të trajtojnë sfidat e sistemit arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe qasjet e politikave të vendeve të tjera europiane dhe më gjerë.

Procesi i aplikimit dhe i pranimit për botim në Revistën Redagogjike

Faza e parë– Dorëzimi i abstraktit

Në fazën e parë të aplikimit, të interesuarit për botim dorëzojnë një abstrakt të çështjeve kryesore që artikulli merr përsipër të trajtojë. Çdo autor ka të drejtë të sjellë vetëm një artikull për botim.

Formati i abstraktit

Titulli i artikullit:

Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve:

Titulli/Grada (nëse ka):

Institucioni ku punon:

Abstrakti i artikullit (*ku përshkruhet fokusi i tij me jo më shumë se 200-250 fjalë*):

Fjalët kyç (*5 – 10 fjalë*):

Dorëzimi i abstraktit duhet bërë deri më datë 30.06.2023, në adresën e emailit: sekretaria@ascap.edu.al.

Faza e dytë – Miratimi i abstrakteve dhe përgatitja e artikujve

Në fazën e dytë, pas shqyrtimit të abstrakteve nga bordi editorial i revistës, ju do të njoftoheni përmes email-it tuaj për pranimin e abstraktit dhe vazhdimin më tej të përgatitjes së artikullit, si dhe dorëzimin e tij në afatin e përcaktuar.

Formati i artikullit të plotë

Titulli i artikullit:

Emri dhe mbiemri i autorit/autorëve:

Abstrakt:

Fjalët kyç:

Hyrje:

Shtjellimi i çështjeve kryesore të artikullit:

Rezultate mbi çështjet kryesore:

Konkluzione/diskutime:

Rekomandime:

Bibliografia:

Kritere për përgatitjen e artikujve të Revistës Pedagogjike

- Numri i faqeve të artikullit të jetë jo më pak se 5 faqe dhe jo më shumë se 12 faqe.
- Artikulli të jetë i shoqëruar me një abstrakt 200-250 fjalë.
- Referencat përgjatë artikullit të vendosen me numra dhe në fund të faqes të vendoset referenca e plotë me shkrim 10, Times New Roman.
- Në fund të artikullit duhet të vendoset bibliografia sipas stilit *APA*.

- Artikulli duhet të jetë i redaktuar nga ana gjuhësore dhe në respektim të gjuhës shqipe standarde.
- Formati të jetë A4, shkrim 12, Times New Roman, me një hapësirë *single* midis rreshtave.

Artikujt do të dorëzohen brenda datës 30.08.2023, në formë elektronike në adresën: sekretaria@ascap.edu.al